

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit D.K., nga fshati Z., komuna R., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Ferizaj, P.nr.401/2015 datë 28.6.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1091/2017 datë 6.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26 mars 2018, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit D.K., paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore Ferizaj, P.nr.401/2015 datë 28.6.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1091/2017 datë 6.11.2017.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj, P.nr.401/2015 datë 28.6.2017, i dënuari D.K. është shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër i është shqiptuar dënim me kusht me të cilin i është vërtetuar dënimi me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në kohën prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i patent shoferit të Republikës së Maqedonisë me nr. MKD-T....

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA.1.nr.1091/2017 datë 6.11.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësi të të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, V.Rr., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit dhe shkelje të ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.246/2017 datë 28.12.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet nga kërkesa në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPPK. Më pas thekson se është shkelur neni 48 të KPK, sepse gjykata nuk ka marrë parasysh provat shfajësuese nga Prokurori i cili procedurën ka filluar kundër personit të gabuar, sepse i dënuari nuk ka qenë person i cili ka kryer këtë vepër penale, pra kemi të bëjmë me error in persona. Më pas, thekson se është shkelur edhe dispozita e nenit 132 par.1 të KPPK, sepse i dënuari është marrë në pyetje në kundërshtim me këtë dispozitë, meqë nuk ka qenë i njoftuar se kundër tij zbatohet procedura penale dhe për këtë ka kuptuar në shqyrtimin gjyqësor dhe gjatë marrjes në pyetje nuk është udhëzuar për të drejtën e tij për të pasur mbrojtës. Shkelje tjetër e dispozitave të procedurës penale, sipas kërkesës, konsiston në atë se gjykata e shkallës së parë i ka refuzuar propozimet e mbrojtjes për një ekspertim të nënshkrimit të dënuarit i cili dallon nga ai në polici dhe dokumentin e falsifikuar. Po ashtu, është shkelur edhe dispozita e nenit 262 par.1 të KPPK, sepse aktgjykimi bazohet në dëshminë e dëshmitarit të dëgjuar i cili kinse ka identifikuar të dënuarin, deklaratë kjo e cila është kundërthënëse me provat tjera.

Potencohet se edhe Gjykata e Apelit të Kosovës aktgjykimin e ka marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se fare nuk ka shqyrtuar prova të reja të bashkangjitura me ankesën e ushtruar kundër aktgjykimin të shkallës së parë, prova këto që kanë të bëjnë me alibinë e të dënuarit e cila sipas pretendimeve nga kërkesa është e mjaftueshme për caktimin e seancës në shkallë të dytë në pajtim me nenin 392 të KPPK.

Pjesa tjetër e kërkesës i referohet shkëljes së ligjit penal e që ka rezultuar si pasojë e vlerësimit të gabuar të provave të çështjes. Kështu theksohet se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ishte personi i cili ishte ndaluar nga policia ditën kritike, se i dënuari kur nuk ka pasur veturën “G.” dhe nuk ka prezantuar fare patent shoferin e falsifikuar të Maqedonisë, numri i telefonit i dhënë policisë nuk është i tij ndërsa me patent shoferin është pajisur në vitin 2009 në Republikën e Kosovës kështu që në praninë e këtyre rrethanave është dashur që të lirohet nga akuza.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se i dënuari D.K. më datë 2.10.2014 rreth orës 10:10 minuta në fshatin D., komuna e F., në rastin e kontrollit rutinor nga policia e trafikut, dëshmitarin G.S. dhe Nj.P., është ndaluar vetura e markës “G.” me ç’rast i dënuari pas kërkesës së dëshmitarit G.S., prezanton patent shoferin të lëshuar nga Republika e Maqedonisë. Meqë dëshmitari ka dyshuar se ky dokument ka qenë i falsifikuar, të dënuarin e kanë shoqëruar në Stacionin Policor në F., ku e kanë dorëzuar te personat e tjerë zyrtar të cilët e kanë marrë në pyetje, ndërsa leja e vozitjes është konfiskuar.

Në këtë çështje penale disa fakte nuk kanë qenë të kontestuese, të cilat nuk janë kundërshtuar as me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Pretendimi kryesor i kërkesës ishte a ka qenë i dënuari personi ndaj të cili është ngritur akuza dhe i cili është shpallur fajtor dhe gjykuar. Kjo çështje, pra identiteti i të dënuarit, është ngritur në fillim të shqyrtimit gjyqësor nga i dënuari dhe mbrojtësi i tij. Për të vërtetuar këtë fakt, gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat e propozuara në bazë të cilave me pa mëdyshje është vërtetuar identiteti i të dënuarit D.K. Kështu, nga shkresat e çështjes rezulton se i dënuari në fillim, ditën kritike kur është sjell në polici në deklaratën e tij të datës 2.10.2014 ka dhënë shënime personale të cilat plotësisht përputhen me shënime të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, përveç faktit se është shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe se vendbanimin e ka në Shkup. Megjithatë, nga shkresat e çështjes rezulton se këtu kemi të bëjmë me të njëjtin person për faktin se nuk mund të jetë thjeshtë një koincidencë lidhur me përputhjen e të dhënave personale pra, janë identike data e lindjes, emrat e të dy prindërve si dhe vendi i lindjes që është në fshatin Z. – komuna e R., me patent shoferin dhe letërnjoftimin e të dënuarit të lëshuar nga autoritetet kosovare. Kjo flet për një realitet e jo për një koincidencë. Nga ana tjetër, nga shkresat e çështjes rezulton se personi në fjalë jeton me familje në Maqedoni dhe numri i telefonit të cilin e ka lënë në polici ishte i kushëririt të tij, i cili gjatë hetimit është kontaktuar nga policia me ç’rast ka konfirmuar se ky person me emrin D. jeton në Maqedoni. Në fund edhe dëshmitari i dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor G.S., ka pohuar se ai ka qenë në patrullë kur ditën kritike e kanë ndaluar të dënuarin i cili ka precizuar edhe vendin e ndalimit të dënuarit dhe të njëjtin

në seancë e identifikon me fjalët "... rasti shumë mirë më kujtohet... po, ky është personi të cilin e kemi ndaluar ...". Prandaj, posedimi i dokumenteve personale të lëshuara nga autoritetet kosovare në asnjë mënyrë nuk mund të vërtetohet alibinë e tij.

Nuk është shkelur dispozita e nenit 132 par.1 të KPPK, nga fakti se siç rezultojnë nga procesverbal i shqyrtimit fillestar i datës 25.11.2016 i dënuari ka qenë i udhëzuar për të drejtat e tij si i pandehur, ndërsa në procesverbal qëndron udhëzimi dhe përgjigja e të dënuarit se i ka kuptuar udhëzimet dhe se për mbrojtës ka angazhuar avokatin V.A., i cili ka qenë prezent gjatë gjithë procedurës, prandaj nuk është shkelur e drejta e të dënuarit në mbrojtje.

Nga shkresat e çështjes – procesverbal i mbi shqyrtimin gjyqësor i datës 15.5.2017 rezultojnë se gjykata e shkallës së parë ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për të bërë ekspertizë grafologjike e nënshkrimit të dënuarit të vënë në patent shoferin, i cili do të duhej të krahasohej me nënshkrimin e vënë në procesverbalin e marrjes në pyetje në polici. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 348 të KPPK, për faktin se ka konsideruar se çështja penale është sqaruar mjaftueshëm. Për më tepër, i dënuari është shpallur fajtor për përdorimin e dokumentit të falsifikuar e që sipas ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë datë 24.10.2014 rezultojnë se dokumenti ishte i falsifikuar, për çfarë gjykata ka dhënë arsye të qarta ligjore.

Nuk është i bazuar pretendimi se i dënuari kur nuk ka poseduar veturën e markës "G." dhe numrin e telefonit të lënë në polici, kjo nga fakti se nga shkresat e çështjes sa i përket telefonit janë dhënë sqarimet më lart në këtë aktgjykim ndërsa vetë i dënuari në deklarin e tij në polici më 2.10.2014 ka deklaruar: "...vetura i përkiste O.B. nga fshati P...", vetura të cilën e kishte drejtuar ditën kritike, e që demanton në tërësi pjesën e mbrojtjes së të dënuarit se ai nuk ka poseduar veturën e markës "G..".

Nga arsyet e dhëna më sipër rezultojnë se identiteti subjektiv i akuzës nuk është cenuar, sepse në mënyrë të sigurt gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar identitetin e të dënuarit të cilin qëndrim e ka pranuar edhe ajo e shkallës së dytë. Është irelevante nëse i dënuari ka poseduar patent shoferin të lëshuar nga autoritetet e RKS për faktin se i njëjti ditën kritike ka përdorur patentin e falsifikuar të Republikës së Maqedonisë e jo patentë shoferin të cituar më lart (i cili sipas ligjeve në fuqi mund të posedoj dy shtetësi dhe dokumentet personale të shteteve gjegjëse).

Nuk është i bazuar pretendimi se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse nuk ka shqyrtuar provat e bashkangjitura me ankesën e paraqitur e që kanë të bëjnë me vërtetimin e alibisë së të dënuarit. Kjo nga fakti se sipas nënti 392 par.1 të KPPK, shqyrtimi para gjykatës së apelit mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për shkak të vërtetimit të

gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës themelore në rigjykim. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë, meqë gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë ashtu që asnjë fakt nuk ka mbetur në mëdyshje, prandaj mbajtja e shqyrtimit në shkallë të dytë nuk ka qenë e nevojshme.

Vlen të theksohet se përshkrimi faktik dhe cilësimi juridik i veprës penale në veçanti identiteti subjektiv i aktgjykimit është rezultat i vlerësimit të drejt të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe si rrjedhojë drejt është aplikuar ligji penal. Po ashtu, vlen të theksohet se dokumentet e prezantuara të bashkangjitura-ankesës nuk mund të provojnë faktet lidhur me alibinë e të dënuarit, respektivisht faktin se i dënuari ditën kritike nuk ka qenë në vendin e ngjarjes meqë prezenca e tij është vërtetuar në mënyrë të sigurt nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe për rrjedhojë drejtë është aplikuar ligji penal.

Nga sa u tha më sipër e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË  
Pml.nr.368/2017, më 26 mars 2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Bulaj

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta